



KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS S.H.A.  
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.  
ENERGETIČKA KORPORACIJA KOSOVO D.D.



Bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës, nenin 5 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2024 dhe Plotësim ndryshimit të UA 03/2024 për rregullimin e konkursit në sektorin publik, bazuar në Kodin e Punës nr. 804 të datës 28.01.2025 të KEK sh.a, si dhe nevojave emergjente të paraqitura për plotësimin e vendeve të lira të punës në Divizionin e Shërbimeve të Korporatës, UD Kryeshefi Ekzekutiv i KEK-ut më 02.04.2025 autorizon Drejtorin e Burimeve Njerëzore që të publikojë konkursin për pozitat e mëposhtme:

## KONKURS

<b>I. Titulli i pozitës:</b>	<b><u>Udhëheqës i Sektorit për Siguri fizike në DPQ e DGJE</u></b>
<b>Institucioni:</b>	Korporata Energjetike e Kosovës
<b>Numri i referencës:</b>	03-28.03.2025
<b>Tipi Akt Emërimit të punës:</b>	Sipas Ligjit të punës 03/L-2012, UA01/2024, plotësim ndryshimi i UA 03/2025 dhe Kodi i punës së KEK-ut
<b>Titulli i mbikëqyrësit:</b>	I raporton Menaxherit të Departamentit për Siguri fizike.
<b>Kohëzgjatja e kontratës:</b>	1 (një) vjeçare me mundësi vazhdimi, ndërsa puna provuese 6 (gjashtë) muaj.
<b>Koeficienti-paga:</b>	700.00 Euro
<b>Procedura e aplikimit:</b>	1 jashtëm
<b>Numri i kërkuar:</b>	2
<b>Vendi i punës:</b>	Korporata Energjetike e Kosovës (KEK sh.a.)

### Detyrat dhe përgjegjësitë:

Bartësi i vendit të punës është përgjegjës për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e të gjitha aspekteve të sigurisë fizike në KEK, duke përfshirë mbrojtjen e personelit (përfshirë palët e treta brenda KEK-ut), pronës dhe informacionit. Do të sigurojë që të gjitha objektet, hapësirat dhe asetet e KEK-ut të mbrohen nga rreziqet e mundshme, duke udhëhequr ekipe sigurie dhe duke bashkëpunuar me autoritetet përkatëse për të garantuar një mjedis pune të sigurt. Përgjegjës për një mjedis të sigurt për stafin dhe palët e treta në KEK sh.a. Kërkon informata dhe raporte nga udhëheqësit e ndërrimeve për siguri fizike, si dhe u jep atyre udhëzime lidhur me çështjet e sigurisë sipas rrethanave dhe nevojës, për të parandaluar çdo rrezik të mundshëm për asetet dhe hapësirat e KEK-ut. Gjithashtu bashkëpunon ngushtë me udhëheqësin për monitorim në Qendrën Monitoruese dhe me Policinë e Kosovës. Analizon rreziqet dhe rekomandon masa për të minimizuar kërcënimet e mundshme. Mbikëqyrë punën e stafit të sigurisë, jep udhëzime për punë dhe sigurohet që të kenë trajnim të vazhdueshëm mbi sigurinë fizike. Mbikëqyrë organizimin e orareve për rojet, përfshirë ndërrimet, rotacionin dhe mbulimin e mungesave, për të siguruar mbulimin e plotë të hapësirave dhe objekteve të KEK-ut. Kontrollon funksionalitetin e pajisjeve të sigurisë si: kamerat e vëzhgimit, sistemet e alarmit, laurat, etj. Sigurohet që të gjitha protokollat e sigurisë të zbatohen në përputhje me rregulloret e KEK-ut dhe ligjet në fuqi. Sigurohet që të kryhen hetime për: incidente, aksidente, vjedhje, tentim vjedhje, avari të ndryshme, etj. dhe propozon masa për përmirësime në aspektin e sigurisë fizike. Përgatit raporte të detajuara (mujore, vjetore, dhe të veçanta sipas rasteve) mbi ngjarjet e sigurisë dhe i paraqet te Menaxheri i Departamentit për Siguri Fizike. Sipas obligimeve ligjore dhe sipas nevojës koordinohet me policinë, zjarrfikësit dhe institucionet tjera të sigurisë. Duhet të ketë njohuri për legjislacionin që i përket fushës së sigurisë fizike. Përgjegjës për mënyrën e komunikimit dhe informimit me kohë për çështjet që lidhen me sigurinë fizike Përgjegjës për lëshimin e Leje Hyrjeve për palët e treta duke respektuar urdhëresat/rregulloret në fuqi Në rast të çdo rreziku të mundshëm dhe me qëllim të parandalimit të aksidenteve/incidenteve obligohet të merr masa të menjëhershme për lokalizimin e zonave ku ka kërcënimet

### Kërkesat profesionale/Kualifikimet

Përgatitje Universitare, së paku Shkollë e Lartë.  
Përvojë udhëheqjeje të paktën 3 (tri) vite në fushën e sigurisë fizike.  
Certifikatë për menaxher të sigurimit për shërbimet themelore, të lëshuar nga MPB.  
Njohuri mbi sistemet e sigurisë dhe menaxhimin e rreziqeve. Njohuri mbi procedurat e sigurisë dhe reagimit ndaj rasteve emergjente.  
Njohuri mbi ligjet dhe rregulloret që lidhen me sigurinë fizike dhe mbrojtjen e objekteve kritike.  
Aftësi të mira komunikuese dhe të punës ekipore. Aftësi të shkëlqyera në udhëheqje, komunikim dhe zgjidhje të problemeve.  
Njohuri të mira të MS Office (Word, Excel, etj). Aftësi për të punuar nën presion dhe për të marrë vendime të shpejta dhe efektive.  
Aftësi për të përdorur pajisje dhe sisteme të ndryshme të sigurisë, si kamerat CCTV dhe sistemet e alarmit.  
Preferohet njohja e gjuhës angleze.

**Dokumentet qe duhet te dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyra e dorëzimit te tyre:**

Gjatë aplikimit online, pas plotësimit të fushave me të dhënat personale të sakta dhe te plota, duhet të keni kujdes në pikat vijuese: Aplikacionin e shkarkuar nga web faqja e KEK-ut e plotësoni, pas plotësimit duhet të ngarkohet në formën e aplikimit online te vegëza: "Ngarko Aplikacionin e plotësuar" vetëm formën tonë që gjendet në web faqen e KEK-ut.

Dëshmia për kualifikimin tuaj: **Diplomën e fakultetit (shkollës së lartë, bachelorit apo masterit), Dëshminë e përvojën se punës me Kontratën e punes ose Vërtetimin mbi përvojën e punës nga organi kompetent, Certifikatën (licencën) për menaxher të sigurimit për shërbimet themelore të lëshuar nga MPB, i skanoni ne një dokument të vetëm (formati .pdf ose .docx ose .doc, madhësia maksimale 5 MB), dhe pastaj e ngarkoni në aplikimin online te vegëza "Ngarko dëshmitë e kualifikimit". Nëse diploma është e fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës se fituar apo aktin qe dëshmon se diploma e fituar është ne procedurë te nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në atë pozitë.**

**II. Titulli i pozitës:**

**Udhëheqs ndërrimi për Siguri fizike në DPQ e DGJE**

**Institucioni:**

**Korporata Energetike e Kosovës**

**Numri i referencës:**

**03-28.03.2025**

**Tipi Akt Emërimit të punës:**

**Sipas Ligjit të punës 03/L-2012, UA01/2024, plotësim ndryshimi i UA 03/2025 dhe Kodi i punës se KEK-ut**

**Titulli i mbikëqyrësit:**

**I raporton Udhëheqësit të Sektorit për Siguri fizike në DPQ e DGJE**

**Kohëzgjatja e kontratës:**

**1 (një) vjeçare me mundësi vazhdimi, ndërsa puna provuese 6 (gjashtë) muaj.**

**Koeficienti-paga:**

**500.00 Euro**

**Procedura e aplikimit:**

**I jashtëm**

**Numri i kërkuar:**

**10**

**Vendi i punës:**

**Korporata Energetike e Kosovës (KEK sh.a.)**

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

Bartësi i vendit të punës është përgjegjës për mbikëqyrjen dhe koordinimin e aktiviteteve të stafit të sigurisë gjatë ndërrimit. Do të sigurojë që të gjitha objektet, hapësirat, asetet e KEK-ut të mbrohen nga rreziqet e mundshme, duke menaxhuar ekipe sigurie dhe duke bashkëpunuar me autoritetet përkatëse për të garantuar një mjedis pune të sigurt. Është përgjegjës për zbatimin e protokolleve të sigurisë dhe menaxhimin e situatave emergjente në mënyrë profesionale dhe efikase.

Bënë pranimin dhe dorëzimin e detyrës në vendin e punës në tri ndërrime në orën 07<sup>00</sup>, 15<sup>00</sup> dhe 23<sup>00</sup>. Në rast të mosardhjes së ndërrimit vazhdohet deri te gjetja e zëvendësimit adekuat, e në rast të dështimit të zëvendësimit vazhdon edhe në ndërrimin vijues. Duhet ta ketë të veshur çdoherë gjatë orarit të punës uniformën e caktuar për stafin e sigurisë fizike. I lexon raportet nga ndërrimi paraprak në librin e raportit të ndërrimit dhe gjatë ndërrimit evidenton të gjitha ngjarjet e rëndësishme që ndodhin, duke precizuar kohën e saktë të ngjarjes, llojin, vendin, veprimet e ndërmarra, etj.

Kontrollon dhe verifikon se a janë në dispozicion dhe funksionale të gjitha pajisjet e nevojshme të stafit të sigurisë fizike, si: radiolidhje, pranga, bateri ndriçimi, detektorë, laurat, kamera vëzhguese (në vendet ku ekzistojnë), sistemet e alarmit, ndriçimi i hapësirave, etj. Në fund të ndërrimit përpilon raportin përmbledhës të gjendjes dhe ngjarjeve në ndërrim.

Sigurohet që procesi i verifikimit (që bëhet nga ana e stafit të sigurisë) të identitetit të punonjësve, vizitorëve, kontraktorëve, etj, që hyjnë apo që ndodhen në hapësirat dhe objektet e KEK-ut, të realizohet me profesionalizëm.

Kryerja e patrullimeve të rregullta në ambientet e KEK-ut bashkë me përgjegjës in e patrullës në ndërrim për të identifikuar rreziqe të mundshme. Reagim i menjëhershëm ndaj situatave emergjente, si: vjedhje, sulme fizike, zjarre ose kërcënime të tjera të sigurisë. Përgjegjës për zbatimin e rregulloreve/procedurave të brendshme të sigurisë fizike me qëllim mbrojtjen e objekteve, hapësirave dhe aseteve të KEK, si dhe përgjegjës për zbatimin e rregulloreve/procedurave tjera relevante të KEK-ut.

Analizon rreziqet dhe rekomandon masa për të minimizuar kërcënimet e mundshme.

Sigurohet që të kryhen hetime për: incidente, aksidente, vjedhje, tentim vjedhje, avari të ndryshme, etj. dhe propozon masa për përmirësime në aspektin e sigurisë.

Sipas obligimeve ligjore dhe sipas nevojës koordinohet me policinë, zjarrfikësit dhe institucionet tjera të sigurisë.

Përdorimi i pajisjeve të sigurisë dhe mjeteve kundër zjarrit për të shuar zjarret e mundshme.

Menaxhimi i çështjeve të brendshme midis stafit dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve me profesionalizëm.

Duhet të ketë njohuri për legjislacionin që i përket fushës së sigurisë.

Përgjegjës për mënyrën e komunikimit dhe informimit me kohë për çështjet që lidhen me sigurinë fizike. Në rast të çdo rreziku të mundshëm dhe me qëllim të parandalimit të aksidenteve/incidenteve është i autorizuar të merr masa të menjëhershme për izolimin e zonave ku ka kërcënime.

Në harmoni me Rregulloret e KEK-ut dhe nivelet tjera të autorizimeve të caktuara kohë pas kohe.

### Kërkesat profesionale/Kualifikimet

Diplomë e shkollës së mesme.

Të ketë së paku 3 (tri) vite përvojë pune në sigurimin fizik të hapësirave dhe objekteve në kompani të ndryshme.

Certifikatë për trajnim themelor profesional për siguri fizike të lëshuar nga MPB.

Njohuri mbi sistemet e sigurisë dhe menaxhimin e rreziqeve. Njohuri mbi procedurat e sigurisë dhe reagimit ndaj rasteve emergjente. Aftësi të mira komunikuese dhe të punës ekipore.

Aftësi bazike në përdorim të kompjuterit. Aftësi për të punuar nën presion dhe për të marrë vendime të shpejta dhe efektive.

Aftësi për të përdorur pajisje dhe sisteme të ndryshme të sigurisë, si kamerat CCTV dhe sistemet e alarmit

### Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyra e dorëzimit të tyre:

Gjatë aplikimit online, pas plotësimit të fushave me të dhënat personale të sakta dhe te plota, duhet të keni kujdes në pikat vijuese: Aplikacionin e shkarkuar nga web faqja e KEK-ut e plotësoni, pas plotësimit duhet të ngarkohet në formën e aplikimit online të vegëza: "Ngarko Aplikacionin e plotësuar" vetëm formën tone që gjendet në web faqen e KEK-ut.

Dëshmia për kualifikimin tuaj: **Diplomën e shkollës së mesme, dëshminë e përvojës së punës me Kontratën e punës ose Vërtetimin mbi përvojën e punës nga organi kompetent, Certifikatën (licencën) për trajnim themelor profesional për siguri fizike të lëshuar nga MPB (i skanoni në një dokument të vetëm (formati .pdf ose .docx ose .doc, madhësia maksimale 5 MB) dhe pastaj e ngarkoni në aplikimin online të vegëza "Ngarko dëshmitë e kualifikimit". Nëse diploma është e fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar apo aktin që dëshmon se diploma e fituar është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në atë pozitë.**

### III. Titulli i pozitës:

### **Përgjygjes patrullues në ndërrim në DPQ e DGJE**

Institucioni:

Korporata Energjetike e Kosovës

Numri i referencës:

03-28.03.2025

Tipi Akt Emërimit të punës:

Sipas Ligjit të punës 03/L-2012, UA01/2024, plotësim ndryshimi i UA 03/2025 dhe Kodi i punës së KEK-ut

Titulli i mbikëqyrësit:

I raporton Udhëheqësit të ndërrimit për Siguri fizike në DPQ e DGJE

Kohëzgjatja e kontratës:

1 (një) vjeçare me mundësi vazhdimi, ndërsa puna provuese 6 (gjashtë) muaj.

Koeficienti-paga:

450.00 Euro

Procedura e aplikimit:

I jashtëm

Numri i kërkuar:

10

Vendi i punës:

Korporata Energjetike e Kosovës (KEK sh.a.)

### Detyrat dhe përgjegjësitë:

Bartësi i vendit të punës bënë Monitorimin dhe kontrollimin e Hyrje-Daljeve. Patrullimin dhe inspektimin e objekteve dhe hapësirave të KEK-ut. Reagon ndaj incidenteve dhe emergjencave përfshirë lajmërimin për çdo sulm apo rrezik të cilin e parasheh apo e vëren, pra rreziqe të mundshme, si: vjedhje, dëmtim, sabotim apo ngjarje të tjera. Sigurimi i mjedisit të sigurt për stafin dhe vizitorët e KEK-ut. I raporton drejtpërdrejt udhëheqësit të ndërrimit për siguri fizike dhe bashkëpunon ngushtë me rojtarin në ndërrim. Pranimi dhe dorëzimi i detyrës bëhet në vendin e punës në tri ndërrime në orën 07<sup>00</sup>, 15<sup>00</sup> dhe 23<sup>00</sup>. Në rast të mosardhjes së ndërrimit vazhdohet deri te gjetja e zëvendësimit adekuat, e në rast të dështimit të zëvendësimit vazhdon edhe në ndërrimin vijues.

Ta ketë të veshur çdoherë gjatë orarit të punës uniformën e caktuar për stafin e sigurisë fizike.

Lexon raportin nga ndërrimi paraprak në librin e raportit të ndërrimit dhe gjatë ndërrimit evidenton të gjitha ngjarjet e rëndësishme që ndodhin, duke precizuar kohën e saktë të ngjarjes, llojin, vendin, veprimet e ndërmarra, etj.

Kontrollon dhe verifikon se a janë në dispozicion dhe funksionale të gjitha pajisjet e nevojshme, si: radiolidhje, pranga, bateri ndriçimi, detektorë, kamera vëzhguese (nëse ka në pikë-rojën e tij), a është ndriçimi në nivel, etj.

Kryerja e patrullimeve të rregullta në ambientet e KEK-ut për të identifikuar rreziqe të mundshme dhe klikon në sistemin e GPS-ve për të dëshmuar prezencën dhe patrullimin.

Ngjarjet e dyshimta që i vëren, përfshirë lëvizjet e dyshimta është i obliguar që menjëherë ta lajmërojë udhëheqësin e ndërrimit për siguri fizike, dhe sipas vlerësimit në rast nevojë edhe Policinë e Kosovës.

Përpilon raportin e ngjarjeve në ndërrim dhe i raporton në fund të ndërrimit udhëheqësit të ndërrimit për siguri fizike.

Verifikon identitetin e vizitorëve, kontraktorëve, etj që hyjnë dhe gjenden në hapësirat dhe objektet e KEK-ut.

Parandalon hyrjen në hapësirat e KEK-ut, të personave të paautorizuar dhe të dyshimtë.

Sigurohet që dyert dhe dritaret e objekteve të jenë të mbyllura siç duhet.

Informon eprorët e sigurisë fizike për çdo dobësi ose të metë që konstatohet e që mund të ndikojë apo ndërlidhet me sigurinë e objekteve dhe hapësirave.

Përgjigjet ndaj kërkesave të eprorëve dhe sigurohet që çdo situatë të trajtohet në përputhje me rregulloret.

Punonjësve që dalin para përfundimit të orarit të punës u kërkojnë leje-daljen e nënshkruar nga udhëheqësi i tyre. Sjellje profesionale dhe etikë e lartë pune.  
Të kërkojë dhe verifikojë dokumentet e identifikimit për palë të treta që hyjnë në objektet e KEK-ut.  
Të kryej kontrole të automjeteve që hyjnë dhe dalin nga hapësirat e KEK-ut, sipas rregulloreve të sigurisë fizike në KEK.  
Në harmoni me Rregulloret e KEK-ut dhe nivelet tjera të autorizimeve të caktuara kohë pas kohe

#### **Kërkesat profesionale/Kualifikimet**

Diplomë e shkollës së mesme.  
Certifikatë për trajnim themelor profesional për siguri fizike të lëshuar nga MPB.  
Të ketë patentë shoferi, së paku kategorinë B.  
Aftësi të mira komunikuese dhe të punës ekipore.  
Njohuri në përdorimin e sistemeve të monitorimit dhe kamerave të sigurisë.  
Përgatitje e mirë fizike për të përballuar detyrat e patrullimit dhe ndërhyrjes në raste emergjente.

#### **Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyra e dorëzimit të tyre:**

Gjatë aplikimit online, pas plotësimit të fushave me të dhënat personale të sakta dhe te plota, duhet të keni kujdes në pikat vijuese: Aplikacionin e shkarkuar nga web faqja e KEK-ut e plotësoni, pas plotësimit duhet të ngarkohet në formën e aplikimit online te vegëza: **“Ngarko Aplikacionin e plotësuar”** vetëm formën tonë që gjendet në web faqen e KEK-ut.  
Dëshmia për kualifikimin tuaj: **Diplomën e shkollës së mesme, dëshminë e patentë shoferit, së paku kategorinë B, Certifikatën (licencën) për trajnim themelor profesional për siguri fizike të lëshuar nga MPB, i skanoni në një dokument të vetëm** (formati .pdf ose .docx ose .doc, madhësia maksimale **5 MB**) dhe pastaj e ngarkoni në aplikimin online te vegëza **“Ngarko dëshmitë e kualifikimit”**. Nëse diploma është e fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar apo aktin që dëshmon se diploma e fituar është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në atë pozitë.

#### **IV. Titulli i pozitës:**

#### **Udhëheqës për monitorim**

**Institucioni:** Korporata Energjetike e Kosovës  
**Numri i referencës:** 03-28.03.2025  
**Tipi Akt Emërimit të punës:** Sipas Ligjit të punës 03/L-2012, UA01/2024, plotësim ndryshimi i UA 03/2025 dhe Kodi i punës së KEK-ut  
**Titulli i mbikëqyrësit:** I raporton Menaxherit të Departamentit për Siguri fizike  
**Kohëzgjatja e kontratës:** 1 (një) vjeçare me mundësi vazhdimi, ndërsa puna provuese 6 (gjashtë) muaj.  
**Koeficienti-paga:** 600.00 Euro  
**Procedura e aplikimit:** I jashtëm  
**Numri i kërkuar:** 1  
**Vendi i punës:** Korporata Energjetike e Kosovës (KEK sh.a.)

#### **Detyrat dhe përgjegjësitë:**

Bartësi i vendit të punës është përgjegjës për udhëheqjen e Qendrës Monitoruese. Sigurohet që pajisjet në qendrën monitoruese janë funksionale dhe që të gjitha objektet dhe hapësirat që janë të mbuluara me kamera monitoruese (sistemi monitorues) të monitorohen nga stafi. Bazuar në informatat dhe evidencat e administratorëve në ndërrim përpilon raporte ditore dhe mujore dhe i përcjell te udhëheqësit e sektorëve për siguri fizike dhe menaxheri i departamentit. Në rast nevojë dhe sipas vlerësimit të situatës lajmëron Policinë e Kosovës për rreziqet e mundshme që vërehen përmes kamerave vëzhguese. Kontrollon dhe verifikon se a janë në funksion të gjitha pajisjet monitoruese, kamerat vëzhguese, pajisjet e alarmit dhe pajisjet tjera në qendrën monitoruese. Në rastet kur ka probleme ndonjëra nga pajisjet që janë të lidhura me qendrën e monitorimit, atëherë e njofton menjëherë shërbimin e IT-së. Lexon dhe kontrollon raportet e administratorëve të ndërrimit në librin e raportit të ndërrimit dhe bënë raportime ditore tek udhëheqësit e sektorëve për siguri fizike dhe tek menaxheri i departamentit.  
Sigurohet që të jetë funksional sistemi i GPS-ve, që ka të bëjë me lëvizjen e veturave dhe raporton (sipas kërkesës për vetura përkatëse) tek menaxheri i Departamentit.  
Përcjell sistemin elektronik për verifikimin e vëzhgimit të rojës në pikë rojën e caktuar se a është funksional dhe a po zbatohet vëzhgimi (apo vizita) nga ana e rojeve dhe raporton për çdo problem që lidhet me këtë sistem.  
Sipas obligimeve ligjore dhe sipas nevojës koordinohet me policinë, zjarrfikësit dhe institucionet tjera të sigurisë.  
Siguron që të gjitha protokollet e sigurisë të zbatohen në përputhje me rregulloret e KEK-ut dhe ligjet në fuqi.  
Përpilon raportet javore dhe mujore të ndodhive/ngjarjeve dhe i dërgon në fund të javës/muajit në e-mailin zyrtar të menaxherit të departamentit për siguri fizike.

### Kërkesat profesionale/Kualifikimet

Diplomë e shkollës së mesme Teknike ose Elektroteknike (teknik i sistemeve të TIK, teknik i informatikës, teknik i kompjuterëve)  
Të ketë minimumi një (1) vit përvojë pune.  
Njohuri të mira të MS Office (Word, Excel, etj).Aftësi të mira komunikuese dhe të punës ekipore.  
Aftësi për të përdorur pajisje dhe sisteme të ndryshme të sigurisë, si kamerat CCTV dhe sistemet e alarmit.

### Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyra e dorëzimit të tyre:

Gjatë aplikimit online, pas plotësimit të fushave me të dhënat personale të sakta dhe te plota, duhet të keni kujdes në pikat vijuese:  
Aplikacionin e shkarkuar nga web faqja e KEK-ut e plotësoni, pas plotësimit duhet të ngarkohet në formën e aplikimit online te vegëza: **“Ngarko Aplikacionin e plotësuar”** vetëm formën tone që gjendet ne web faqen e KEK-ut.  
Dëshmia për kualifikimin tuaj: **Diplomën e shkollës se mesme, dëshminë e përvojës se punës me Kontratë ose Vërtetimin mbi përvojën e punës nga organi kompetent (i skanoni ne një dokument të vetëm (formati .pdf ose .docx ose .doc, madhësia maksimale 5 MB) dhe pastaj e ngarkoni në aplikimin online të vegëza “Ngarko dëshmitë e kualifikimit”**. Nëse diploma është e fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës se fituar apo aktin që dëshmon se diploma e fituar është ne procedurë te nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në atë pozitë.

### Mënyra e aplikimit

Aplikimi është online, ngarkoni dokumentet sipas kërkesave në konkurs. Aplikimi juaj është i kompletuar vetëm nëse e merrni e-mailin konfirmues. Për çdo paqartësi dhe për siguri në aplikim kontaktoni në numrin e telefonit: 038 501-401-2671,045355111 por mund të shkruani edhe në e-mailin (ofertapune@kek-energy.com) për të vërtetuar aplikimin tuaj (vetëm nëse nuk keni pranuar e-mailin konfirmues).

### Njoftimi me rezultatin e konkursit publik

Kandidatët do të njoftohen individualisht me rezultatin e këtij konkursi duke e respektuar Udhëzimin administrativ nr. 01/2024, plotesim ndryshimin e UA 03/2024 dhe Kodin e punës nr. 804 te datës 28.01.2025 për rregullimin e konkursit në sektorin publik.

### Mënyra e vlerësimit të aplikantëve/kandidatëve:

Jetëpërshkrimi (CV) deri tridhjetë (30) pikë  
Intervista vlerësohet deri shtatdhjetë (70) pikë

Në rast të pikëve të barabarta në fund të testimit (shkrim) dhe vlersimit te Cv-së, përparësi do të kenë kandidatët nga komuna e Obiliqit dhe zonat tjera të rrezikuara konform ligjit nr. 05/l-044.

Për më shume informata për poziten e lartpërmendur vizitoni web-faqen: **www.kek-energy.com**, ikona ‘Shpallje’ dhe mund ta shkarkoni aplikacionin për pozitën që aplikoni.

### Vërejtje:

Gjatë aplikimit online, pas plotësimit të fushave me të dhënat personale të sakta dhe të plota, duhet të keni kujdes si në vijim: **Nëse nuk e deklaroni që anëtar i familjes së ngushtë ju punon në KEK, në cilëndo fazë që vërtetohet, aplikacionet e juaja do të refuzohen. Aplikacionet pas afatit nuk do të pranohen, ndërsa ato të mangëta ose që nuk janë në formatin e kërkuar më lartë do të refuzohen.** Kandidati i suksesshëm do të sistemohet në pozitën për të cilën ka aplikuar sipas kësaj shpalljeje dhe në afatin prej 3 (tri) viteve nga dita e kontratës së parë nuk ka të drejtë ri-sistemimi në vend tjetër të punës, përveç në raste të jashtëzakonshme me lejimin e KE të KEK.

Kalendari i përafërt: brenda 25 ditësh vlersimi i cv-së dhe intervista me goje . Njoftimi final brenda 10 ditësh nëse nuk ka ankesa të cilat e pezullojnë afatin e paraparë sipas UA 01/2024, plotësim ndryshimi i UA 03/2024 dhe në bazë të Kodit të Punës nr. 804 te datës 28.01.2025.

Data e aplikimit deri më 17.04.2025 ora 24:00  
Prishtinë, 02.04.2025

Divizioni i Burimeve Njerëzore

